



Organizata për Siguri dhe  
Bashkëpunim në Evropë  
**Prezenca në Shqipëri**

**FJALA E KRYETARIT TË PREZENCËS NË CEREMONINË E HAPJES SË  
TRAJNIMIT SIMULUES “HETIMI DHE IDENTIFIKIMI I TRAFIKIMIT TË QENIEVE  
NJERËZORE NË SHQIPËRI”**

*18 tetor 2021*

Jam i nderuar që ju takoj të gjithëve sot këtu dhe hap zyrtarisht trajnimin e parë simulues në Shqipëri për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Prezenca e OSBE-së në Shqipëri i ka dhënë përparësi prej kohësh luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe ky trajnim simulues ngërthen shumë elementë kyç të punës sonë, nga ndjekja e një qasjeje që bazohet te të drejtat e njeriut dhe vendos në qendër viktimën, te çuarja përpara e bashkërendimit ndërinstytucional dhe midis aktorëve të ndryshëm, te përdorimi i mjeteve dhe i metodave më të fundit për krijimin e kapaciteteve dhe forcimin e kundërpërgjigjes.

Nuk është rastësi që ky trajnim fillon sot, në ditën evropiane kundër trafikimit, e cila shërben si një datë e veçantë për të rritur ndërgjegjësimin për trafikimin e qenieve njerëzore dhe për të rritur shkëmbimin mes palëve të ndryshme të interesit që punojnë në këtë fushë.

Ky trajnim simulues është organizuar në bashkëpunim të ngushtë me Zyrën e Përfaqësuesit të Posaçëm dhe Koordinatorit të OSBE-së për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe bazohet në një metodologji të re, rreth së cilës kolegët e mi të nderuar do t'ju tregojnë më shumë në sesionet në vijim. Jemi të nderuar që kemi rastin të mirëpresim personalisht kolegët tanë nga Zyra e Përfaqësuesit të Posaçëm, me të cilët kemi punuar ngushtë në përgatitjen e këtij simulimi. Po ashtu, do të kemi mundësi të ndjekim në video pak më vonë z. Valiant Richey, Përfaqësuesin e Posaçëm.

Gjithashtu, do të doja të falënderoja zonjën zëvendësministre të Brendshme, Romina Kuko, dhe zonjën zëvendësministre të Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes Sociale, Denada Seferi, për faktin se institucionet që ato përfaqësojnë janë partnere të hershme të Prezencës në Shqipëri në përpjekjet kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Çmoj angazhimin e tyre dhe të qeverisë shqiptare në jetësimin e këtij ushtrimi dhe mundësimin e pjesëmarrjes së shumë prej jush që gjendeni sot këtu.

Gjithashtu, do të doja të falënderoja qeverinë e Mbretërisë së Bashkuar për bujarinë në financimin e kësaj veprimtarie, e cila organizohet në kuadër të programit kundër trafikimit të qenieve njerëzore, i cili zbatohet nga një konsorcium organizatash nën udhëheqjen e UNICEF-it në Shqipëri. Dëshiroj të ndalem këtu për të shprehur vlerësimin e lartë si për ambasadën britanike në Tiranë, ashtu dhe për UNICEF-in në Shqipëri, përfshirë përkatësisht edhe këshilltaren për Drejtësinë dhe Punët e Brendshme, njëherazi edhe atashenë për klimën në ambasadë, Harriet Morgan si dhe Përfaqësuesin e UNICEF-it në Shqipëri, Roberto de Bernardi, të cilët janë këtu sot me ne, për të parë këtë ushtrim simulues, realizuar me mjetet më të mira të mundshme.

Në të vërtetë, ky simulim vjen pas një kohe të gjatë. Planet u ndërpre, u vonuan dhe modifikuan disa herë në këta 18 muajt e fundit për shkak të pandemisë dhe ekspertët kanë punuar për të garantuar që ky trajnim të mund të kryhet në mënyrën më efektive dhe më të sigurt të mundshme. Përpjekjet nuk u ndalën, pasi ishte e rëndësishme që të bënim bashkë pjesëmarrësit për të mundësuar përdorimin në praktikë të qasjeve të reja, mjeteve të reja dhe mënyrave të reja të komunikimit dhe bashkëpunimit. Gjatë këtyre ditëve, ju do të punoni me simulime në kohë reale, përmes të cilave do të mësoni se si të identifikoni dhe hetoni trafikimin e qenieve njerëzore dhe si të ndihmoni personat e trafikuar në përputhje me qasjet që vendosin viktimën në qendër dhe respektojnë të drejtat e njeriut.

Shumë shpesh, ne diskutojmë për trafikimin e qenieve njerëzore si për një krim - një krim i tmerrshëm - por unë do të doja që të gjithë ne sot të sjellim në vëmendje se trafikimi i personave është, së pari dhe mbi të gjitha, një shkelje e të drejtave të njeriut, dhe se ne të gjithë kemi përgjegjësi të thellë për t'iu kundërvënë kësaj plaje tragjike. Të gjithë jemi të vetëdijshëm për problemet komplekse dhe thelbësore në ndjekjen dhe dënimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe se për këtë vepër penale hetimet duhet të respektojnë të drejtat e viktimave në çdo fazë të procedimit.

Janë dashur shumë përgatitje për këtë trajnim, por ai do të bëhet i suksesshëm vetëm falë angazhimit dhe pjesëmarrjes së plotë nga ana juaj, pjesëmarrësit tanë të përkushtuar. Unë ju nxis që të tregoni gjatë trajnimit të njëjtën shkallë vëmendjeje dhe angazhimi që tregoni gjatë punës tuaj të përditshme - si policë, si prokurorë, si punonjës socialë, si inspektorë, si aktivistë. Shumë prej jush janë caktuar për të qenë këtu nga institucionet tuaja përkatëse. Pjesëmarrja juaj aktive pasqyron në mënyrë të përkryer përparësinë që OSBE-ja, qeveria e Shqipërisë, shoqëria civile dhe ju vetë i jepni luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore.

Në të vërtetë, asnjë institucion apo individ nuk mund të punojë i vetëm në trajtimin e trafikimit të qenieve njerëzore. Si në çdo sfidë të përbashkët, zgjidhja nuk është kurrë tek “unë”, por gjithmonë te “ne”. Vetëm pak muaj më parë, pata nderin të bashkë-organizojmë një konferencë për kundërpërgjigjen shumëpalëshe ndaj trafikimit të qenieve njerëzore me Përfaqësuesin e Posaçëm, Valiant Richey, ku theksuam, në mënyrë të veçantë, nevojën e fuqizimit të përpjekjeve për identifikimin e rasteve të viktimave të mundshme të trafikimit si dhe të sistemit të referimit dhe të ndihmës së përshtatshme. Kjo kërkon më shumë bashkëpunim midis policisë dhe të gjithë aktorëve të fushës, përfshirë OJF-të, për identifikimin, informimin dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit, dhe garantimin e trajtimit njerëzor të viktimave gjatë hetimeve dhe procedimeve penale.

Përpara se ta mbyll, do të doja të shprehja mirënjohjen time për të gjithë kolegët, anëtarët e qeverisë, për të gjitha palët e përfshira dhe veçanërisht për stafin tim fantastik, për kolegët e mi në Prezencën e OSBE-së këtu në Shqipëri. Jam i sigurt se përkushtimi ynë i përbashkët do të sjellë rezultate të prekshme dhe shumë domethënëse dhe mezi pres të shoh përfundimet e këtij ushtrimi simulues.

Shumë faleminderit!